

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK VLORË

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit

Analiza e Humbjeve të Ujit për Sha UK Rajonale Vlorë

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjiellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihet parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo qasje i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme gjatë aktivitetit të tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. ***Në këtë kuadër shoqëritë duhet të rrisin kujdesin dhe angazhimin e tyre për të patur të dhëna sa më të plota dhe të sakta, që aktualisht përbën një problem serioz të besueshmërisë së tyre.***

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Ujësjiellësve). Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të FU, mungesën e matësve në burim, si dhe mungesën e organizimit të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të) dhe në përgjithësi mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down). Në këtë metodë hartimi të bilancit të ujit fokusi është llogaritja e humbjeve totale duke filluar nga përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej të humbjeve reale.

Sa më sipër, analiza e humbjeve të ujit për vitin 2022, për të gjitha shoqëritë të cilat janë riorganizuar në shoqëri rajonale është kryer sipas përshkrimit të mësipërm.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Ekzistuese UK Vlorë

Shoqëria rajonale UK Vlorë përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Vlorë, UK Himarë dhe UK Selenicë. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Vlorë jepen në tabelën 1.

Nga të dhënat e Tabelës 1, probleme të nën faturimit me matje u konstatua për ish shoqërinë UK Himarë (77.2 l/ditë, banor), e cila duhet të kryejë verifikimet mbi lidhjet dyfishe në rrjetet e furnizimit sidomos e zonat rurale, duke patur parasysh që 100 l/ditë, banorë është konsumi mesatar ditor. Probleme me faturimin aforfe rezultuan tek Njësia Vlorë (184.9 l/ditë, banorë), njësia Selenicë (211.3 l/ditë, banorë), të cilat duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij arsye të mbi faturimit, sepse referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 konsumi mesatar për banor duhet të jetë 150 litra/banor në ditë. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëria Himarë (43 l/ditë, banorë), duhet të analizojë me kujdes arsyet e këtij nën faturimi nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh. R UK Vlorë	Popullsia* me Shërbim	Konsumi Total (në m3)	Konsumi i Matur (në m3)	Konsumi i Pamatur (në m3)	Nr. Lidhjeve Me Matës	Nr. Lidhjeve Pa matës	Konsumi i Matur	Konsumi Aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
Vlorë	99,804	4,581,310	2,341,350	2,239,960	35,977	17,926	96.3	184.9	125.8
Himarë	12,265	335,000	321,500	13,500	5,349	403	77.2	43.0	74.8
Selenicë	7,364	551,600	137,900	413,700	1,158	3,108	189.0	211.3	205.2
Totali	119,433	5,467,910	2,800,750	2,667,160	42,484	21,437	96.7	182.4	125.4

Referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet krahasuar keto rezerva me kërkesë për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektivë dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R UK Vlorë	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem (në m ³)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimeve (m ³ /vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Vlorë	99,804	23,176,300	125.8	108,649	35,715,952	900.6	774.9
Himarë	12,265	1,215,900	74.8	13,465	2,503,958	509.5	434.6
Selenicë	7,364	2,514,970	205.2	9,867	8,467,416	2351.1	2145.9
Totali	119,433	26,907,170	125.4	131,981	46,687,326	969.2	843.7

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë përlllogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2, konstatohet se **shoqëria rajonale UK Vlorë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë**, për popullsinë totale të regjistruar në zonën e saj të shërbimit.

Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjithë zonën e shërbimit, për të arritur objektivin e ofrimit të shërbimeve të FU konsumatorëve me cilësi të lartë, me kohëzgjatje FU 24/7” në të gjithë zonën e shërbimit.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Vlorë

Për vitin 2022, ish shoqëria UK Vlorë ka prodhuar 23,176,300 m³ ujë, prej së cilës **vetëm 10% rezulton i matur**, pjesa tjetër 90% është i vlerësuar.

Shërbimi me furnizimin me ujë ofrohet për rreth 91.9% të popullsisë në juridiksion.

Numri i lidhjeve me ujin raportohet 60,083 lidhje nga të cilat 40,714 lidhje ose 67.8% janë të pajisur me aparate ujëmatës.

“UPA” rezulton në nivelin 75.16%.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjise për zvogëlimin e humbjeve me prioritet DMA-të më problematike.

Në tabelën 3 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Vlorë.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për ish Shoqërinë UK Vlorë- Viti 2022.

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	23,176,300	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,317,444	14.31%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	2,439,776	10.53%
Faturimi Total	5,757,220	24.84%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	44,080	0.19%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,276,400	5.51%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	5,497,500	23.72%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	2,441,200	10.53%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	9,215,100	39.76%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	4,479,200	19.33%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	440,000	1.90%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	350,000	1.51%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	2,150,000	9.28%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	740,700	3.20%
Humbjet Reale (Teknike)	8,159,900	35.21%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	17,375,000	74.97%
UJI PA TË ARDHURA	1,207,280	75.16%

Komente :

- UPA në nivelin 75.16% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele të performancës së dobët, e cila duhet të përmirësohet.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 90 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 40,714 klientë dhe përbëjnë 67.8% të klientëve që i ofrohet ky shërbim.
- Numri i klientëve familjarë me matës është 35,977 që përbëjnë 88.3% të totalit të klientëve me matës.
- Konsumi i faturuar është 24.84%, në të cilin vetëm 14.31% është konsum i matur, ndërsa pjesa tjetër është i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 35.21%, ku humbjet nga rrjedhjet në linjat e transmetimit janë 19.33% dhe 9,28% ato në rrjetin shpërndarës që konsiderohen vlera të larta. Shoqëria duhet të verifikojë evidencat nëse çarjet (difektet) rezultojnë mjaft të shpeshta të linjave të transmisionit, si dhe të verifikohet gjendja fizike e tyre për të ndërhyrë me masa për uljen e këtyre humbjeve.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 39.76% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 29.23%, si dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 10.53%, të cilat konsiderohen mjaft të larta.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar, duke qenë se shoqëria 90% të sasisë së ujit në prodhim e ka të vlerësuar, e bën jo të besueshme vlerën e volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht atë të treguesit UPA.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që vetëm 10% e sasisë së ujit të prodhuar matet, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar, që përcaktohet me vlerësim, duke u bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet; për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 35.21%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 19.33% dhe në rrjetin e transmetimit 9.28%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të defekteve që ndodhin gjatë vitit, që të merren masa të gjenden fondet nga pushteti qendror ose vet shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre.*

- *Të kryhen vazhdimisht kontrolle dhe të bëhen verifikimet e duhura mbi lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes që janë në vlerën prej 29.23%, për tu siguruar që ato janë vërtet të pranishme në keto vlera. UK Vlorë, duhet të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Vlorë për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e FU dhe të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së. Për klientët të cilët faturohen aforfe të bëhen saktësimet e duhura lidhur me numrin banorëve për çdo lidhje, bazuar në certifikatën familjare aktuale, për të patur faturim korrekt.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 10.53% të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi dhe në varësi të këtyre gjetjeve të merren masa për të kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, të kontrollohen lexuesit e matësve, si edhe të verifikohen nëse janë të pajisur me ujëmatësa shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Të trajtojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit.*

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Himarë

Për vitin 2022, ish shoqëria UK Himarë ka prodhuar 1,215,900 m³ ujë, **i cili është 100% është i vlerësuar pasi mungojnë matësat në burime.**

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Himarë ofrohet për 12,265 banorë ose 91.1% të popullsisë në juridiksion.

Numri i lidhjeve që furnizohen me ujë raportohet 6,359 lidhje nga të cilat 5,956 lidhje ose 93.7% janë të pajisur me aparate ujëmatës.

“UPA” rezulton në nivelin 59.4%.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me prioritet DMA-të më problematike.

Në Tabelën 5 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Himarë.

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Himarë – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,215,900	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	455,140	37.43%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	38,510	3.17%
Faturimi Total	493,650	40.60%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	22,000	1.81%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	94,000	7.73%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	95,250	7.83%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	101,000	8.31%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	290,250	23.87%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	95,000	7.81%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	48,000	3.95%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	35,000	2.88%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	223,000	18.34%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	9,000	0.74%
Humbjet Reale (Teknike)	410,000	33.72%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	700,250	57.59%
UJI PA TË ARDHURA	722,250	59.40%

Komente :

- UPA në nivelin 59.40% të prodhimit vjetor konsiderohet në nivele të larta.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 5,956 klientë dhe përbëjnë 93.7% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Numri i klientëve familjar me matës është 5,349 klientë dhe përbëjnë 84.1% të klientëve total me matës.
- Konsumi i faturuar është 40.6%, prej të cilit 37.43% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 33.72%, përkatësisht prej 7.81% përbëhen nga humbjet prej rrjedhjeve në linjat e transmetimit dhe 18.34% në rrjetin shpërndarës, shifra të cilat konsiderohen të larta. Për këtë shoqëria duhet të verifikojë evidencat e difekteve (çarje) të linjave të transmisionit, gjendje fizike të tyre për të marrë masat përkatëse për uljen e këtyre humbjeve.
- Niveli i humbjeve të dukshme është në nivelin prej 23.87% shkaktuar nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 15.56%, si dhe në vlerën prej 8,31% dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim, konsiderohen gjithashtu mjaft të larta.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar sepse 100% e sasisë së ujit të prodhuar është e vlerësuar (jo e matur), e ben jo të besueshme vlerën e volumit të ujit të prodhuar, si dhe ate të treguesit UPA.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që nuk matet por vlerësohet e gjithë sasia e ujit të prodhuar, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar, që përcaktohet kryesisht me vlerësim, duke u bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet; për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 33.72%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 18.34% dhe në rrjetin e transmetimit 7.81%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të defekteve që ndodhin gjatë vitit, që të merren masa të gjenden fondet nga pushteti qendror ose vet shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre.*
- *Nga një Task Forcë të kryhen vazhdimisht kontrole dhe verifikime mbi lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes 15.56%, për të evidentuar praninë e tyre. Më tej të hartohet një plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së. Për klientët të cilët faturohen aforfe (43 l/ditë, banorë) të bëhen saktësimet e duhura lidhur me numrin banorëve për çdo lidhje, bazuar në certifikatën familjare aktuale, për të patur faturim korrekt.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 8.31% të ujit të prodhuar, njësi duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi për të kolauduar matësat ose ndërruar matësat e vjetër, të kontrollohen lexuesit e matësve, si edhe a janë të pajisur me ujëmatës shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit.*

II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Selenicë

Për vitin 2022, ish shoqëria UK Selenicë ka prodhuar 2,514,970 m³ ujë, i cili është **100% është i vlerësuar** pasi mungojnë matësat në burim. Shërbimi i furnizimit me ujë në këtë Njësi ofrohet për 7,364 banorë ose 74.6% të popullsisë në juridiksion. Numri i lidhjeve që furnizohen me ujë raportohet lidhje nga të cilat 1,248 lidhje ose 28.1% janë të pajisur me aparate ujëmatës. “UPA” rezulton në nivelin 75.99%, e dhënë e marrë nga sektori i monitorimit, pasi shoqëria për disa vite rresht pavarësisht asistencës nga ERRU nuk ka mundur ta plotësojë Bilancin e ujit.

Zona e shërbimit të kësaj Shoqërie ka një shtrirje shumë të madhe dhe rrjeti shpërndarës i FU nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Në Tabelën 6 paraqitën komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Selenicë.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Selenicë – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	2,514,970	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	156,310	6.22%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	447,570	17.80%
Faturimi Total	603,880	24.01%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	-	0.00%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	-	0.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	955,545	37.99%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	-	0.00%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	955,545	37.99%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	-	0.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	-	0.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	955,545	37.99%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	-	0.00%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	-	0.00%
Humbjet Reale (Teknike)	955,545	37.99%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	1,911,090	75.99%
UJI PA TË ARDHURA	1,911,090	75.99%

Komente :

- UPA në nivelin 75.99% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele të larta e të papranueshme.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 1,248 klientë dhe përbëjnë 28.1% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Numri i klientëve familjar me matës është 1,158 klientë dhe përbëjnë 92.8% të klientëve total me matës.
- Konsumi i faturuar është 24.01%, prej të cilit vetëm 6.22% është konsum i matur pjesa tjetër i pamatur.
- Niveli i humbjeve të dukshme dhe atyre reale janë secila pranohen aforfe në nivelin 37.99%, e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem. Kjo ndarje aforfe bëhet për shkak të mungesës së historikut të plotësimit të Bilancit të ujit nga ana e shoqërise.

- Pasaktësia e mundshme gjatë përlogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar, duke qenë se shoqëria sasinë së ujit të prodhuar e ka 100% të vlerësuar, i ben jo të besueshme vlerën e volumit të ujit të prodhuar dhe të treguesit UPA.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që e gjithë sasia së ujit të prodhuar nuk matet, i bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit të kësaj shoqërie. Nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Duhet marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar, që përcaktohet me vlerësim, duke u bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet; për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Shoqëria të ketë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Nisur nga vështirësitë e kësaj njësie për plotësimin e Bilancit të ujit ndër vite, shoqëria rajonale duhet patjetër të marrë masa për të trajnuar vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit.*

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë

Shoqëria Rajonale UK Vlorë, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Vlorë , Himarë dhe Selenicë. Kjo shoqëri ka në juridiksion 131,981 banorë. Shërbimin e furnizimit me ujë e marrin **119,433 banorë** ose **90.5%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet **70,885 lidhje**, nga të cilat **47,918 lidhje** ose **68 %** janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **26,907,170 m³ rezulton i matur në nivelin 9%**, nevoja për ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura është në nivelin **74.52%** të ujit që hyn në sistem dhe shoqëria faturon vetëm **6,854,750 m³ ujë** ose **25.48%** të prodhimit.

Tabela 7, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Vlorë.

Tabela 7. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë – Viti 2022

Emërtimi	Njësia	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	m ³	26,907,170	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	m ³	3,928,894	14.60%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	m ³	2,925,856	10.87%
Faturimi Total	m³	6,854,750	25.48%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	m³	66,080	0.25%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	m ³	1,370,400	5.09%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	m ³	6,548,295	24.34%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	m ³	2,542,200	9.45%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	m³	10,460,895	38.88%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	m ³	4,574,200	17.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	m ³	488,000	1.81%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	m ³	1,340,545	4.98%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	m ³	2,373,000	8.82%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	m ³	749,700	2.79%
Humbjet Reale (Teknike)	m³	9,525,445	35.40%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	m³	19,986,340	74.28%
UJI PA TË ARDHURA	m³	20,052,420	74.52%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 74.52% të prodhimit vjetor është më i lartë se mesatarja e sektorit për të gjithë vendin, konsiderohet mjaft i lartë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për “Ujin e prodhuar”, në nivelin 9% është i papranueshëm, gjë e cila i bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 25.48%, prej të cilit 14.6% është konsum i faturuar i pamatur.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 47,918 klientë dhe përbëjnë 68% të totalit të klientëve që e marrin këtë shërbim, i cili për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë duhet të jetë sa më afër 100%.
- Numri i Klientëve familjar me matës është 42,484 klientë ose 88.7% e totalit të klientëve me matës.
- Niveli i humbjeve reale është 35.40% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht zërin më të madhe e zënë humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit në nivelin 17%, rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 8.82%, ndërsa humbjet për shkak të riparimeve 2.79%.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 38.88 % e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 29.43 % të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 9.45%.

- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi stafi i shoqërisë has mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që vetëm 9% e sasisë së ujit të prodhuar matet nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë vetëm 9% e ujit matet, i bën jo të besueshme vlerën e volumit të ujit të prodhuar dhe të vlerave të të gjithë komponenteve të Bilancit të ujit.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, evidentim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës (me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale), pasi 21,437 klientë familjar janë pa matës, që përbëjnë 45% të klientëve total me matës, ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë. Humbjet reale janë në nivelin 35.4% dhe vijnë kryesisht nga rrjedhjet në linjat e transmetimit 17%, shoqëria duhet të japi argumenta të mëtjeshme për justifikimin e tyre, të analizojë dhe të monitorojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi, të cilat janë në nivelin 9.45%, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar ose ndërruar matësat e vjetër etj.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale, për shkak të shtrirjes së madhe që ka kjo shoqëri rajonale.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së .
- Të ngrihet një Task Forcë për verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si dhe të kontrollohen lexuesit e matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.
- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.
- Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.
- Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale, duke filluar me vitin 2023, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.